Kronikë

‘Lëshoje armën në tokë…policia’, arrestohen dy të rinj në Tiranë, lëviznin të armatosur! Ja çfarë u sekuestrua (EMRAT+VIDEO)

Dy të rinjve iu gjetën dy armë gjahu. Dy të tjera, pistoletë, u gjetën në banesën e njërit prej tyre. U sekuestruan gjithashtu edhe municion luftarak dhe një sasi kokaine.

Redaksia
5 Dhjetor, 09:09 | **Përditesimi: 5 Dhjetor, 10:30**

Share

Dy të rinj janë arrestuar nga policia e Tiranës pasi lëviznin të armatosur. Ilir Dushku, 29-vjeç dhe Bjorli Xhabrahimi, 22-vjeç u ndaluan në Mjull Bathore dhe pas një kontrolli fizik, policia iu gjeti armë. Dushkut iu gjet 1 armë gjahu teke me 29 fishekë ndërsa Xhabrahimit iu gjet një armë tjetër gjahu.

Më pas, policia ushtroi kontrolle në banesën e Ilir Dushkut, të cilit i gjeti edhe dy armë pistoletë, 1 armë e ftohtë, municion luftarak dhe një sasi e vogël kokainë. 29-vjeçari rezulton i dënuar më parë për plagosje të rëndë me dashje dhe heqje e paligjshme lirie.

Emri i Ilir Dushkut del në një ngjarje të ndodhur në vitin 2017, në një konflikt pronësie mes dy familjesh. Ilir Dushku, së bashku me disa kushërinj të rinj janë konfliktuar me një familje tjetër, ku për pasojë u plagosën 4 persona.



LEXO EDHE:
Atentati me 2 viktima në Rinas, policia shoqëron një person për ta marrë në pyetje

Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni policor i koduar "Hunter", për goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje dhe lëndëve narkotike.

Operacioni u zhvillua nga Komisariati i Policisë Nr. 1.

Sekuestrohen 2 armë zjarri, 2 armë gjahu, 1 armë e ftohtë, municion luftarak dhe lëndë narkotike.

Vihen në pranga 2 shtetas që qarkullonin me automjet, me armë me vete, njëri prej tyre i dënuar më parë për krime kundër personit.

Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, si dhe bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1 organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Hunter".

Në kuadër të këtij operacioni, u kapën dhe u arrestuan shtetasit:
I. D., 29 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Heqja e paligjshme e lirisë" dhe B. Xh., 22 vjeç, banues në Tiranë.

Këta shtetas u kapën gjatë operacionit, në Mjull Bathore, Tiranë, dhe gjatë kontrollit fizik ndaj tyre, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 armë gjahu teke dhe 29 fishekë arme gjahu që i posedonte shtetasi I. D. dhe një armë tjetër gjahu që e posedonte shtetasi B. Xh.

Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit I. D., Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale, 2 armë zjarri pistoleta, municion luftarak, 1 armë të ftohtë dhe një sasi të vogël lëndë të dyshuar narkotike kokainë.

Në bashkëpunim me Prokurorinë vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.D/Shqiptarja.com

TAG: armembajtje pa leje | Tirane | ilir dushku | bjorli xhabrahimi | policia e tiranes

Komento

Komente

Njoni: 05/12/2025 10:53
Dalin prap pas 2 vitesh ket gjykat kemi ne. E bojn prap ca dun.
Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
8 Dhjetor, 11:46
Shpallja e pluralizmit në Shqipëri në 1990, kush e ka meritën e vërtetë?

Studentët | Sali Berisha | Të gjitha bashkë

Lajme të tjera

Vrau Martinin dhe plagosi shokun pranë shkollës, Gjykata e Tiranës dënon me 16 vite burg autorin 15-vjeçar! Engjëll Cani: Vendimi, rreze drite për ne
9 Dhjetor, 14:15

VIDEO/ Arrestohet hajduti 21-vjeçar në Tiranë, shtynte edhe një të mitur të vidhte! Sekuestrohen veshje policie, radio, pranga, municion luftarak
8 Dhjetor, 11:09

I dënuar në Francë për trafik droge, Prokuroria e Tiranës kërkon konfiskimin e pasurive të Elton Arkaxhiut! Një truall dhe dy biznese 336 mijë euro
8 Dhjetor, 10:16

Sherr mes dy grupeve në Fresk, në hetim 5 persona! Dhunuan me grushte 4 të tjerë
8 Dhjetor, 10:06

Hodhi lëndë piroteknike në fushë gjatë derbit Tirana-Partizani, nis hetimi për 20-vjeçarin
8 Dhjetor, 09:58

Tiranës i ka mbetur vetëm fanella, Partizani 'hakmerret' dhe e mposht 0-2 në derbi! Bardhebllutë mbeten në fundin e renditjes

Stavro Dhimitri
7 Dhjetor, 16:56

Rrugorja e Tiranës bën bilancin: 136 gjoba në 48 orët e fundit, mbi 2 mijë për parkime të gabuara! 11 shoferë të arrestuar
7 Dhjetor, 15:54

Sot derbi Tirana - Partizani, policia tregon rrugët që do bllokohen në kryeqytet! Tifozët do shoqërohen për në stadium
7 Dhjetor, 14:05

Sfida numër 210-të/ Peshorja 'anon' nga të kuqtë, statistikat e derbit të sotëm mes Tiranës dhe Partizanit
7 Dhjetor, 13:59

Sot Tirana - Partizani në 'Air Albania', tifozët braktisin derbin! Ja sa bileta janë shitur
7 Dhjetor, 12:03

Vidhte sende të ndryshme nga automjete e subjekte në Tiranë, vihet në pranga 34-vjeçari, arrestohet dhe 48-vjeçari që blinte materialet e vjedhura (EMRAT)
7 Dhjetor, 10:26

'Dhjetori i festave', pamjet magjike nga 'Sheshi Skënderbej' (VIDEO)
6 Dhjetor, 20:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje